


Vlerësimi Mjedisor

RAPORTI I TË GJETURAVE NGA
HULUMTIMI I OPINIONIT



Komuna e Fushë Kosovës



...për qytetin tim!

Vlerësimi Mjedisor

RAPORTI I TË GJETURAVE NGA HULUMTIMI I OPINIONIT



Komuna e Fushë Kosovës

Përmbajtja

PARATHËNIE	7
PËR PROJEKTIN	8
HYRJE	9
METODOLOGJIA	10
1. PERCEPTIMI PËR GJENDJEN E TANISHME MJEDISORE	13
1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e komunës tuaj?	13
1.2. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj?	14
1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës suaj?	15
1.4. Dy institucionet që merren më së tepërmi me zgjidhjen e problemeve mjedisore?	16
1.5. Në rast se keni ndonjë problem në lidhje me mjedisinin, ku do të ishit drejtura?:	17
2. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT	18
2.1. A jeni të njoftuar me ndonjë nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal?	18
2.2. A i nevojitet komunës një strategji e re zhvillimore?	19
2.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm në komunën tuaj?	20
2.4. A është zhvillimi i tanishëm komunal në përputhshmëri me nevojat e juaja?	21
2.5. A posedon komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?	22
2.6. A dini ndonjë OJQ e cila maret me çështjet e mjedisore në komunën tuaj?	22
2.7. Emrat e OJQ-ve që veprojnë në komunën tuaj për mbrojtje të mjedisit:	23
2.8. A jeni të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes së mjedisit?	23
2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?	24
2.10. A mendoni se ju duhen më tepër informata rreth gjendjes së mjedisit?	25
2.11. A është e nevojshme pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje rreth mjedisit?	25
2.12. A jeni të gatshëm të bëni punë vullnetare për zgjidhjen e disa problemeve të mjedisit?	26
3. VIZIONI ZHVILLIMOR	27
3.1. Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedisit në 5 vitet e ardhshme në komunën tuaj?	27
3.2. Tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj	28
KONKLUZIONET	30

PARATHËNIE

Në përputhje me Dekleratën e misionit, dhe në mbështetje të legjislacionit mjedisor vendor, Qendra Rajonale e Mjedisit- REC Zyra në Kosovë e sheh si të domosdoshme përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore qoftë në nivelin qendror edhe atë lokal.

Në këtë frymë, në kuadër të projektit për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) për Komunën tuaj, duke u mbështetur edhe në Metodologjinë e pranuar nga partnerët, REC Zyra në Kosovë ka ndërmarrë hulumtimin e opinionit publik të qytetarëve të komunës suaj, çka konkretisht qytetarët shohin si problem kryesor dhe cka propozojnë për zgjidhje.

Ky vlerësim dhe kjo përfshirje është një nga fazat më të rëndësishme të punës në procesin e hartimit të PLVM-së. Ky proces ndër të tjera ka qëllim që t'i ndihmohet edhe grupit punues komunal dhe të ekspertëve në procesin e hartimit të PLVM duke pasur për bazë edhe gjithpërfshirjen. Mbi këtë është bazuar edhe motoja e projektit PLVM...për qytetin tim!.

Mendimi i secilit në procesin e hartimit të dokumentit duhet dhe do të konsiderohet. Nga ky aspekt falënderojmë të gjithë ata qytetarë, pa dallim etnie, gjinie, profesioni e statusi shoqëror që kanë ndarë kohën e tyre për të plotësuar Pyetsorët e përgatitur. Kjo qasje është një pjesë e përgjegjësisë qytetare për mjedisin lokal por edhe një copëz pronësie e qytetarëve mbi dokumentin e PLVM së komunës respektive që do të aprovohet në fund të procesit.

REC-u si implementues i projektit është i kënaqur dhe nderuar që përmes këtij vlerësimi gjithpërfshirës, përmes Pyetsorëve kemi prekur dyert e rreth 11.000 familjeve, duke i bërë pjesëmarrës të procesit por edhe duke bërë indirekt një fushatë senzibilizimi për nevojën e përmirimit të situatës mjedisore në të mire të shëndetit dhe shoqërisë tonë.

Ky Raport, përveç për procesin e hartimit të PLVM-së mund të shfrytëzohet edhe nga institucione, ekspertë dhe hulumtues për zhvillime të mëtutjeshme në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm për komunën tuaj.

Në fund si implementues të projektit, REC falenderon Qeverinë suedeze dhe Sida për mbështetjen e ofruar financiare për Vlerësimin dhe Raportin si dhe projekti e PLVM-së në tërësi. Shpreh mirënjohjen time edhe për Kryetarin e Komunës, anëtarët e Grupit Punues e veçanarisht për dy koordinatorët komunal dhe të REC-ut të PLVM-së, për partneritetin e treguar në fazën e deritashme të projektit.

Një falënderim i veçantë vlen edhe për OJQ- partnere që përmes vullnetarëve të tyre kanë bërë të mundur shpërndarjen, plotësimin, mbledhjen dhe futjen e të dhënave në database, ku më tutje u përpunuan nga eksperti i angazhuar për përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e këtij Raporti z. Burim Leci.

Falënderimi më i madh, përsëri shkon për qytetarët që janë pjesë e këtij Raporti, duke ju dëshiruar suksese dhe një mjedis sa më të shëndetshëm për ju familjet dhe qytetin tuaj.

Prof. Dr. Zeqir Veselaj
Drejtor, REC Zyra në Kosovë

PËR PROJEKTIN

Qëllimi kryesor i projektit Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Qëndrueshmëri në Kosovë përqipet që të reduktoj varfërinë në Kosovë që do të arrihej duke thyer "ciklin" shterimi i burimeve / degradimi i mjedisit - Dështimin e ekonomisë - të varfërisë së zgjeruar nga zhvillimi i PLVM-ve në 10 komuna. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet promovimit të cilësisë më të mirë të jetës për qytetarët e sidomos për të varfëritë dhe grupet e marginalizuara, të iniciojë aktivitete ekonomike me realizimin e projekteve mjedisore që do të çojnë drejt përmirësimit të kushteve të jetesës të qëndrueshme.

Projekti i propozuar ndihmon zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve lokale në Kosovë për planifikimin e qëndrueshmërisë dhe menaxhimin duke adresuar çështjet e minimizimit të degradimit të mjedisit, të decentralizimit, fuqizimin e institucioneve vendore, duke e zvogëluar efektet negative të ndërrimeve në strukturat politike, duke rritur shpejtësinë e reformave institucionale. Kjo është në një vijë me kërkesat e decentralizimit dhe regjionalizimit si qëllimet e reformave të parashikuara në negociata dhe / ose marrëveshjeve për përafrimin e Kosovës me BE-në.

Objektivat e projektit të PLVM-së korrespondojnë direkt me synimet më të gjera të Programit REC për Mbështetje e Nismave Lokale në Evropën Juglindore. Ky projekt është financuar nga Sida dhe realizuar nga REC me komunat partnere si përfitues. Objektivat e projektit gjithashtu korrespondojnë me prioritetet e investimeve të rekomanduara për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (siç paraqitet në grafikun më sipër) dhe përgjigjet në dështimet e qeverisjes dhe fushat specifike të politikës neglizhuse², si dy nga katër çështjet që njihen si arsye për mangësitë në arritjen e MDGs³.

Objektiva 1: Përmirësimi i planifikimit mjedisor

Ky projekt i njeh të dyja, kërkesat ligjore në komunat përfituese dhe nevojat e shprehura nga përfaqësuesit e komunave dhe palët e interesuara vendore siç është shkruar në dokumentin Konkluzionet e Përbashkët të miratuar në konferencën rajonale "Udhërrëfyesit për Qëndrueshmërinë Lokale në Evropën Juglindore" në Beçej 2006, të vazhdojë të punojë në zhvillimin e PLVM-ve. Ky projekt do të udhëheq 10 komuna të Kosovës për të ngritur kapacitetet lokale dhe nacionale në përmirësimin e praktikave të planifikimit mjedisore.

Objektiva 2: Ofrimi i investimeve mjedisore

Projekti do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për projektet prioritare lokale me bashkëfinancim të parashikuar nga komunat përfituese. Fokus shtesë i investimeve të lidhura me aktivitetet do të jetë identifikimi i mënyrave më të mira të mundshme të përfshirjes së burimeve të financimit në dispozicion lokale dhe nacionale (p.sh. nacionale eko-fondet dhe të tjerët) në PLVM-të e zhvilluara në komunitetet përfituese. Kjo në mënyrë efektive kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të komuniteteve lokale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të tyre

Objektiva 3: Përmirësimin e menaxhimit mjedisor

Ndihma e drejtpërdrejtë në menaxhimin mjedisor është identifikuar si një nga faktorët kyç për fuqizimin e njerëzve të varfër dhe përmirësimin e kushteve, sidomos në komunat me minoritete, vendbanimet e marginalizuara dhe komunat e mëdha me sfidat më të mëdha urbane dhe zhvillimit të pabarabartë të lagjeve. Ujë më të mirë, higjienë, dhe infrastrukturë për menaxhimin e mbeturinave, sistemet e mbrojtjes nga ndotja dhe integrimi i strategjive sektoriale lokale janë të nevojshme në komunitete lokale në Kosovë

HYRJE

Me qëllim që hartimi i Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të merr në konsideratë opinionin e qytetarëve mbi çështjet e ndryshme mjedisore, gjatë muajit nëntor të vitit 2011 është realizuar hulumtimi në teren me 10 komuna të përzgjedhura për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM). Komunitet të cilat kanë shpreh interes dhe janë përzgjedhura që të hartojnë PLVM-në janë: Fushë Kosova, Mitrovica, Deçani, Hani i Elezit, Graçanica, Istogu, Obiliqi, Juniku, Podujeva dhe Parteshi.

Të gjeturat nga ky hulumtim fillimisht do të jenë në dispozicion të grupeve punuese nëpër komunitet të përzgjedhura për hartimin e PLVM-së, në mënyrë që të marrin në konsideratë opinionin e qytetarëve nga komunitet përkatëse. Të gjeturat e hulumtimit do të ndihmojnë anëtarët e grupeve punuese që të trajtojnë tema të ndryshme gjatë hartimit të PLVM-ve, apo të forcojnë argumentet e tyre gjatë përzgjedhjes së pozicioneve të ndryshme në PLVM.

Hulumtimi në terren është realizuar nga organizatat joqeveritare mjedisore të cilat veprojnë në komunitet e përzgjedhura për hartimin e PLVM-së. Gjatë hulumtimit në terren anëtarët e organizatave joqeveritare përpos që kanë intervistuar respondentët në bazë të shpërndarjes së mostrës, ata edhe i kanë informuar qytetarët për rëndësinë e PLVM-së, dhe mundësinë e dhënies së kontributit të tyre në hartimin e PLVM-së. Për këtë arsye, realizimi i hulumtimit në terren, ka rezultuar me informim të drejtpërdrejtë prej më tepër se 11.000 respondentëve të përzgjedhur (qytetarëve të intervistuar) për të marrë pjesë në hulumtim. Të dhënat e mbledhura në terren, më pas janë proceduar në programin kompjuterik SPSS, i cili është program i specializuar për nxjerrjen rezultateve nga hulumtimet kuantitative sociale.

Gjetjet e hulumtimit janë të prezantuara në kapitullin e të gjeturave kryesore dhe janë të ndara për çdo komunitet. Të gjeturat për çdo komunitet janë të ndara si në vazhdim: *perceptimi për gjendjen e tanishme mjedisore, strategjia e zhvillimit dhe informimit si dhe vizioni zhvillimor.*

METODOLOGJIA

Qendra Regionale e Mjedisit zyra në Kosovë (REC), për të realizuar këtë hulumtim në teren ka angazhuar organizatat joqeveritare mjedisore të cilat veprojnë në komunat e përzgjedhura për hartimin e PLVM-së. Roli i organizatave të angazhuara ka qenë që të intervistojnë respondentët, t'i bartin të dhënat e hulumtimit tek koordinatori i hulumtimit, si dhe të informojnë të intervistuarit shkurtimisht në lidhje me PLVM-në.

Para se të filloj hulumtimi në teren, REC-u ka organizuar trajnim një ditor për hulumtuesit, të cilët janë përzgjedhur nga organizatat joqeveritare përgjegjëse për realizimin e hulumtimit në teren. Në këtë trajnim është shpjeguar përmbajtja e pyetësorit; mënyra e administrimit të pyetësorit; mënyra e intervistimit; shpërndarja e mostrës dhe rëndësia e respektimit të përpiktë të saj; konfidencialiteti dhe kodi etik gjatë intervistimit.

Hulumtimi është realizuar në dhjetë komuna të përzgjedhura për hartimin e PLVM-ve. Numri i respondentëve për komuna është përzgjedhur në bazë të regjistrimit të popullsisë, realizuar gjatë pranverës së vitit 2011 (shih tabelën e më poshtme për ndarjen e numrit të respondentëve për komuna). Më tej, mostra e respondentëve është ndarë në bazë të gjinisë dhe në bazë të grupmoshave. Ndarja në mes të gjinive është bërë në bazë të të dhënave nga regjistrimi i fundit i popullsisë, ndërsa ndarja në grupmosha është bërë duke marr për bazë numrin e popullsisë që korrespondon me grupmoshën përkatëse si dhe statusin e tyre social, ekonomik dhe politik në të tashmen dhe të ardhmen e afërt. Ndarja e numrit të respondentëve në mes të gjinisë dhe grupmoshave është paraqitur në tabelën në vijim.

	Gjinia	Meshkuj					Femra					
		gr. mosha nr. i respod.	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%
1 Deçan	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
2 Fushë Kosovë	2000	102	204	442	204	68	98	196	425	196	65	
	Fushë Kosovë (ALB - 85%)	1700	87	173	376	173	58	83	167	361	167	55
	Fushë Kosovë (MIN - 15%)	300	15	31	66	31	10	15	29	64	29	10
3 Graçanicë	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
	Graçanicë (SRB - 90%)	450	23	46	99	46	15	22	44	96	44	15
	Graçanicë (MIN - 10%)	50	3	5	11	5	2	2	5	11	5	2
4 Hani i Elezit	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
5 Istog	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
	Istog (ALB - 95%)	475	24	48	105	48	16	23	47	101	47	16
	Istog (MIN - 5%)	25	1	3	6	3	1	1	2	5	2	1
6 Junik	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
7 Mitrovicë	3500	179	357	773	357	119	172	343	743	343	114	
	Mitrovicë (ALB - 80%)	2800	143	286	619	286	95	137	274	594	274	91
	Mitrovicë (MIN - 20%)	700	36	71	155	71	24	34	69	149	69	23
8 Obiliq	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
	Obiliq (ALB - 90%)	450	23	46	99	46	15	22	44	96	44	15
	Obiliq (MIN - 10%)	50	3	5	11	5	2	2	5	11	5	2
9 Partesh	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16	
10 Podujevë	2000	102	204	442	204	68	98	196	425	196	65	
	Podujevë (ALB - 95%)	1900	97	194	420	194	65	93	186	403	186	62
	Podujevë (Min - 5%)	100	5	10	22	10	3	5	10	21	10	3
	Nr i respondentëve	11000	561	1122	2431	1122	374	539	1078	2335	1078	359

Respondentët apo qytetarët e intervistuar janë përzgjedhur me metodën e rastit d.m.th për secilën pikënisje, çdo i treti person është ftuar për intervistë apo në çdo të dytën shtëpi është trokitur për

intervistë. Respondentët kanë pasur mundësinë që të japin (apo mos të japin) të dhënat e tyre për t'u informuar rreth hartimit të PLVM-së në komunën e tyre. Këto të dhëna kanë shërbyer edhe për të kontrolluar cilësinë e hulumtimit në teren. Një numër i konsideruar i të anketuarve, të cilët kanë lënë në dispozicion kontaktet e tyre, janë kontaktuar për të vërtetuar vlefshmërinë e hulumtimit në teren – me shpërndarjen e mostrës dhe kështu me këtë kontroll të cilësisë është arritur vlefshmëria e hulumtimit. Pas mbledhjes së të dhënave në teren, pyetësorët janë administruar në programin kompjuterik të quajtur SPSS dhe janë gjeneruar të dhënat dhe grafikët për përgjigjet e dhëna nga respondentët.

SHËNIM:

Grafikët dhe tabelat në pyetjet me numër rendor (1.2.), (1.3.), (1.4.), (2.3.), (2.9.) dhe (3.1.)¹ në total japin një përqindje më të lartë se 100 %. Kjo është si rrjedhojë e fuzionimit të të dhënave nga më tepër se një tabelë apo grafik në një tabelë apo grafik të vetëm. Në këtë mënyrë është mundësuar që të nxirret në mënyrë të saktë prioriteti i çështjeve të ndryshme për pyetjet në fjalë. Kjo do të thotë, se për pyetjen (1.2) në vend që të paraqiten pesë tabela dhe grafikë të ndryshëm ato janë të shprehura me një grafik dhe tabelë të vetme – e cila mundëson leximin sa më të lehtë të të gjeturave nga lexuesit e raportit.

¹ 1.2. Pesë problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj; 1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës tuaj; 1.4. Dy institucionet që merren më së tepërmi me zgjidhjen e problemeve në fushën e mjedisit; 2.3. Çka duhet të jetë baza e zhvillimit të ardhshëm në komunën tuaj?; 2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?; 3.1. Rrumbullakosni 3 problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj

Fushë Kosovë

Shpërndarja e mostrës për komunën e Fushë Kosovës

Komuna	Gjinia	Meshkuj (51%)					Femra (49%)				
		Mosha # i resp.	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%	65+ 7%	>18 10%	18-25 20%	25-50 43%	50-65 20%
Fushë Kosovë	2000	102	204	442	204	68	98	196	425	196	65
Fushë Kosovë (ALB - 85%)	1700	87	173	376	173	58	83	167	361	167	55
Fushë Kosovë (MIN - 15%)	300	15	31	66	31	10	15	29	64	29	10



Për realizit të këtij hulumtimi në pjesët urbane të Fushë Kosovës janë intervistuar 2000 respondent, ku prej tyre 85 % kanë qenë shqipëtarë dhe 15 % nga radhët e minoritetëve. Kjo shpërndarje e mostrës është ndarë tutje në aspektin gjinor: 51 % meshkuj dhe 49 %, ndarje e bazuar në të dhënat e rexhistrimit të popullsisë të realizuar gjatë pranverës së vitit 2011. Ndarja e mostrës ka filluar tutje të shpërndahet nëpër grupmosha, si për meshkuj ashtu edhe për femra: 10 % e respondentëve kanë përbërë grupmoshën nën 18 vjeç; 20 % për grupmoshën 18 deri në 25 vjeç; 43 % për grupmoshën 25 deri në 50 vjeç; 20 % për grupmoshën 50 deri në 65 vjeç; si dhe 7 % për grupmoshën mbi 65 vjeç. Kjo ndarje në grupmosha është bazuar në numrin e respondentëve që përbëjnë në atë grupmosh, ndikimin dhe reflektimin që kanë në jetën sociale, politike dhe ekonomike, si dhe ndikimin dhe reflektimin që mund të kenë në të ardhmen e afërt.

1. Përceptimi për gjendjen e tanishme mjedisore

1.1. Gjendja e tanishme mjedisore në territorin e komunës e tuaj

		e mirë	e kënaqshme	e pakënaqshme	nuk e di
Gjinia	Mashkull	234	255	515	28
		22.7%	24.7%	49.9%	2.7%
	Femer	260	250	432	38
		26.5%	25.5%	44.1%	3.9%
Total		494	505	947	66
		24.6%	25.1%	47.1%	3.3%

Në pyetjes se si e vlerësoni gjendjen e tanishme mjedisore në territorin e komunës tuaj, shumica e respondentëve nga Fushë Kosova janë përgjegjur se: gjendja në territorin e komunës së tyre është e pakëndshme me gjithsej 47.1%, e kënaqshme me 25.1% dhe e mire 24.6%. Kjo përgjigje nuk varion tepër kur krahasohet në mes të dy gjinive, për më tepër shih ilustrimin në grafet e më poshtme.



1.2. Pese problemet kryesore në fushën e mjedisit në komunën tuaj



Gjinia	Mashkull	zhurma	mbeturinat e grumbulluara komunale	ujërat e zeza / kanalizimet	cilësia e ajrit	cilësia e ujit të pijshëm	rrugët jo të mira lokale, shtigjet, mungesa e parkingjeve
			544	434	827	741	455
		22.7%	27.2%	21.7%	41.4%	37.1%	22.8%
	Femer	413	554	432	810	756	401
		20.7%	27.7%	21.6%	40.5%	37.8%	20.1%
Total		866	1098	866	1637	1497	856
		43.3%	54.9%	43.3%	81.9%	74.9%	42.8%

Si problem kryesore mjedisore qytetarët nga Fushë Kosova kanë listuar²:

- Cilësin e ajrit**, si problemin kryesor
- Cilësin e ujit të pijshëm**, si problemin e dytë më të rëndësishëm
- Menaxhimin e mbeturinave komunale**, si problemin e tretë më të rëndësishëm
- Ujrat e zeza/ kanalizimet**, si dhe
- Zhurma**, janë renditur si problem i katërt dhe i pestë për nga rëndësia.

Edhe në këtë rast rënditja e problemeve mjedisore nuk ka ndryshuar për nga përceptioni gjinor, për ilustrim shih grafet në vazhdim.

² SHËNIM: Grafet dhe tabelat në pyetjet me numër rëndor (1.2), (1.3), (1.4.), (2.3), (2.9) dhe (3.1) në total japin një përqindje më të lartë se 100 përqind. Kjo është si rrjedhojë e fuzionimit të të dhënave nga më tepër se një tabelë apo graf në një tabelë apo graf të vetëm. Në këtë mënyrë është mundësuar që të nxierret në mënyrë të saktë prioritetimi i qëstjeve të ndryshme për pyetjet në fjalë. Kjo do të thotë, se për pyetjen (1.2) në vend që të paraqiten pesë tabela dhe grafe të ndryshme ato janë të shprehura me një grafë dhe tabelë të vetme – e cila mundëson leximin sa më të lehtë të të gjeturave nga lexuesit e raportit.




Si probleme tjera mjedisore, qytetarët e Fushë Kosovës kanë listuar: mungesa e kontenjerëve, elektrifikimi i rrugëve, mos menaxhimi i mbeturinave, mungesa e parqeve, mungesa e hapsirave rekreative sportive, ndezja e zjarreve.

1.3. Tre ndotësit kryesor të mjedisit në territorin e komunës tuaj

		industria	ekonomia e vogël	kanalizimi	mbeturinat komunale	trafiku
Gjinia	Mashkull	844	127	494	449	516
		42.2%	6.4%	24.7%	22.5%	25.8%
Femer	785	112	455	450	479	
		39.3%	5.6%	22.8%	22.5%	24.0%
Total		1629	239	949	899	995
		81.5%	12.0%	47.5%	45.0%	49.8%

Si ndotës kryesor mjedisor në komunën e Fushë Kosovës respondentët kanë paraqitur: **industrinë, trafikun, kanalizimin** dhe **mbeturinat komunale**. Kjo ndarje nuk varion tepër në aspektin gjinor, për më tepër shih paraqitjen grafike.





Si ndotës tjerë responentë nga Fushë Kosova kanë listuar: ndezjen e zjarrave lokale, ndezja e gomave, vetë qytetarët, mungeas e kontinjerëve, menaxhimi i dobët i mbeturinave, pluhuri, qentë endacak.

1.4. Dy institucionet që merren me se tepërmi me zgjidhjen e problemeve në fushën e mjedisit

		qeveria komunale	ndërmarrje t publike komunale (ujë, mbeturina, kanlizim, gjelbrim)	mjetet lokale të informimit	organiza tat joqeverit are ose shoqëria civile	qytetar ët	askush
Gjinia	Mashkull	684	427	69	41	217	233
		34.2%	21.4%	3.5%	2.1%	10.9%	11.7%
Femer		706	466	47	32	212	167
		35.3%	23.3%	2.4%	1.6%	10.6%	8.4%
Total		1390	893	116	73	429	400
		69.5%	44.7%	5.8%	3.7%	21.5%	20.0%

Responentët nga *Fushë Kosova* më se tepërmi mbështetën tek **qeveria komunale** në zgjedh e problemve në fushën e mjedisit, kurse si alternativë të dytë zgjedhin **ndërmarrjet publike komunale**. Për më tepër shih ilustrimin grafik.







1.5. Në rast se personalisht keni ndonjë problem që është në lidhje me mjedis, për zgjidhjen e këtij problemi së pari do të ishit drejtuar tek

		zyra komunale kompetente për mjedis (ose zyrtarit komunal për mjedis)	inspektoriati komunal	ndërmarrja publike komunale	organizata joqeveritare	mjetet lokale të informimit	policia	tjetër (shënoni)
Gjinia	Mashkull	755	49	74	20	12	33	87
		73.3%	4.8%	7.2%	1.9%	1.2%	3.2%	8.4%
Gjinia	Femer	795	41	58	9	22	17	33
		81.5%	4.2%	5.9%	.9%	2.3%	1.7%	3.4%
Total		1550	90	132	29	34	50	120
		77.3%	4.5%	6.6%	1.4%	1.7%	2.5%	6.0%

Për problemet individuale mjedisore qytetarët e *Fushë Kosovës* fillimisht do të drejtoheshin tek **zyra komunale kompetente për mjedis**, dhe më pas tek **ndërmarrjet publike komunale**. Shih ilustrimin grafik në vijim.







Disa nga qytetarët e Fushë Kosovës, janë shprehur se në rast se kanë problem personalisht me qështje të mjedisit atëherë ata nuk kanë ku të drejtohen, e disa janë shprehur se mund të adresojnë këto qështje në ministrinë përgjegjëse për mjedis apo parlament.

2. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE INFORMIMIT

2.1. A jeni të njoftuar me ndonjë nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal?

		PO	JO	nuk e di a ekziston diçka e tillë
Gjinia	Mashkull	161	619	252
		15.6%	60.0%	24.4%
	Femer	146	568	266
		14.9%	58.0%	27.1%
Total		307	1187	518
		15.3%	59.0%	25.7%



Shumica e qytetarëve të intervistuar të *Fushë Kosovës* janë shprehur se nuk janë të njoftuar me qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal me 59.0%; apo nuk janë në dijeni se ekziston diçka e tillë me 25.7%; përderisa vetëm 15.3% shprehen se janë në dijeni mbi qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal. Për ilustrim shih grafet e më poshtme.



2.2. A i nevojitet komunës një strategji e re zhvillimore?

		PO	JO	nuk e di a ekziston diçka e tillë
Gjinia	Mashkull	799	67	166
		77.4%	6.5%	16.1%
Femer		711	53	216
		72.6%	5.4%	22.0%
Total		1510	120	382
		75.0%	6.0%	19.0%

Në pyetjen se a i nevojitet komunës së *Fushë Kosovës* një strategji e re zhvillimore, shumica e qytetarëve të intervistuar janë shprehur se po i nevojitet me 75.0%, nuk i nevojitet me 6.0%, dhe se nuk e dinë se a ekziston diçka e tillë me 19.0%. Sa i përket kësaj pyetje si femrat ashtu edhe meshkujt kanë pikëpamje pothuajse të njëjtë. Për më tepër shih ilustrimin në vazhdim.




2.3. Çka duhet të jetë bazë e zhvillimit të ardhshëm të komunës suaj?


		industria	zejtaria	bujqësia	turizmi	prodhimi i produkteve ekologjikisht të pastra	gjuetia dhe peshkimi	tjetër (shënoni)
Gjinia	Mashkull	752	281	424	121	222	47	23
		37.6%	14.1%	21.2%	6.1%	11.1%	2.4%	1.2%
	Femer	748	300	296	98	273	41	11
		37.4%	15.0%	14.8%	4.9%	13.7%	2.1%	.6%
Total		1500	581	720	219	495	88	34
		75.0%	29.1%	36.0%	11.0%	24.8%	4.4%	1.7%

Si bazë për zhvillimit të ardhshëm të *Fushë Kosovës*, qytetarët e intervistuar listojnë:

- i) **Industrinë,**
- ii) **Bujqësinë,**
- iii) **Zejtarinë,**
- iv) **Prodhimi i produkteve ekologjikisht të pastërta,** e të tjera.

Shih ilustrimin grafik për rëndësinë e dhënë, nga të intervistuarit, për fushat bazë për zhvillim të komunës së tyre në të ardhmën.






2.4. A është zhvillimi i tanishëm komunal në përputhshmëri me nevojat e juaja?

		PO	shume pak	Jo
Gjinia	Mashkull	281	441	310
		27.2%	42.7%	30.0%
	Femer	302	418	260
		30.8%	42.7%	26.5%
Total		583	859	570
		29.0%	42.7%	28.3%



Shumica e qytetarëve të intervistuar, shprehen se zhvillimi i tanishëm i *Fushë Kosovës* nuk përkon me nevojat e qytetarëve: 42.7% shprehne se *shumë pak* zhvillimi i tanishëm komunal i përshtatet nevojave të tyre, 28.3% nuk i përkon me nevojat e tyre, përdori sa 29.0% mendojnë se zhvillimi komunal është në harmoni me nevojat e qytetarëve. Shih grafet në vijim për ilustrim vizuel.



2.5. A posedon komuna personin/shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit?

		PO	JO	Nuk di
Gjinia	Mashkull	433	201	398
		42.0%	19.5%	38.6%
	Femer	462	129	389
		47.1%	13.2%	39.7%
Total		895	330	787
		44.5%	16.4%	39.1%


Një numër i konsideruar i qytetarëve të intervistuar, janë në dijeni se komuna e *Fushë Kosovës* posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtjen e mjedisit. Në përqindje 44.5% janë shprehur se komuna posedon personin apo shërbimin që merret me mbrojtje të mjedisit, 16.4% shprehen që komuna nuk e ka këtë shërbim, ndërsa 39.1% nuk e dijnë se a e posedon komuna këtë shërbim apo jo. Shih grafet në vijim për ilustrim pamor.



2.6. A dini ndonjë organizatë joqeveritare e cila në mënyre aktive është duke u marrë me çështjet e mbrojtjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		PO	JO
Gjinia	Mashkull	34	998
		3.3%	96.7%
	Femer	12	968
		1.2%	98.8%
Total		46	1966
		2.3%	97.7%

Shumica e qytetarëve të intervistuar nga *Fushë Kosova* nuk janë në dijeni për ekzistencën apo veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile që meren me çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Në përqindje 97.7% janë shprehur se nuk ekzistojnë organizata të tilla në territorin e komunës së tyre.





2.7. Emrat e organizatave që njohin respondentët në komunën e tyre:

BSF, RAA, Health for all, KCSF, Përspektiva Energjetike, Rrezet e arta të Ashkalinjëve.

2.8. A jeni të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		po	në përgjithësi	shumë pak	jo	nuk e di se informohet për këtë
Gjinia	Mashkull	128	268	274	279	83
		12.4%	26.0%	26.6%	27.0%	8.0%
	Femer	100	264	261	229	126
		10.2%	26.9%	26.6%	23.4%	12.9%
Total		228	532	535	508	209
		11.3%	26.4%	26.6%	25.2%	10.4%



Nga të gjeturat e hulumtimit qytetarët e intervistuar të *Fushë Kosovës* në përgjithësi nuk janë të kënaqur me shkallën e informimit rreth gjendjes mjedisore në komunën e tyre. Për këtë 25.2% janë përgjigjur se nuk janë fare të kënaqur me shkallën e informimit, 26.6% shumë pak të kënaqur, 26.4% në përgjithësi të kënaqur, për deri sa vetëm 11.3% janë shprehur se janë të kënaqur me shkallën e informimit. Për ilustrim shih grafet në vijim.



2.9. Nga informoheni rreth gjendjes mjedisore në komunë?

		gazetat ditore	radio stacionet	televizionet	organet kompetente komunale	tjetër (shënori)
Gjinia	Mashkull	779	401	771	336	100
		39.0%	20.1%	38.6%	16.8%	5.0%
	Femer	683	351	749	300	109
		34.2%	17.6%	37.5%	15.0%	5.5%
Total		1462	752	1520	636	209
		73.1%	37.6%	76.0%	31.8%	10.5%

Si medime të informimit për gjendjen mjedisore, qytetarët e intervistuar të *Fushë Kosovës*, kanë përzgjedhur **televizionin** si mediumin **primar**, **gazetat ditore** si mediumin **sekondar**, dhe **radio stacionet** si mediumin **terciar**. Për ilustrim vizuel shih grafet në vijim.





Si medium tjera të informimit qytetarët e Fushë Kosovës, listojnë: internetin, bashkë qytetarët, shkollën, observimin personal, OJQ-të, revistat, taksitë.

2.10. A mendoni se ju duhen më shumë informata rreth gjendjes së mjedisit në territorin e komunës suaj?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	876	83	72
		85.0%	8.1%	7.0%
	Femer	790	62	128
		80.6%	6.3%	13.1%
Total		1666	145	200
		82.8%	7.2%	9.9%



Shumica e qytetarëve të intervistuar të *Fushë Kosovës*, në pyetjen se a ju duhen më tepër informata rreth gjendjes mjedisore në territorin e komunës tuaj? me 82.8% janë shprehur se kanë nevojë për më tepër informata për gjendjen mjedisore në komunën e tyre. Kjo përgjigje nuk varion tepër mes respondentëve meshkuj dhe femra. Për ilustrim shih grafet në vijim.



2.11. A është e nevojshme pjesëmarrja drejtpërdrejtë më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje rreth mjedisit?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	928	43	60
		90.0%	4.2%	5.8%
	Femer	858	22	100
		87.6%	2.2%	10.2%
Total		1786	65	160
		88.8%	3.2%	8.0%



Shumica e konsideruar e qytetarëve të intervistuar të *Fushë Kosovës*, janë shprehur se pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e qytetarëve në proceset e vendimmarrëse është e nevojshme. E shprehur në përqindje 88.8% shprehen se pjesëmarrja është e nevojshme. Kjo përqindje nuk varion teper mes respondentëve meshkuj dhe femra, për ilustrim grafik shih grafet në vazhdim.



2.12. A jeni të gatshëm që vullnetarisht të përfshiheni në punë në zgjidhjen e disa nga problemeve komunale të mjedisit?

		po	jo	nuk e di
Gjinia	Mashkull	688	201	143
		66.7%	19.5%	13.9%
Femer		568	244	168
		58.0%	24.9%	17.1%
Total		1256	445	311
		62.4%	22.1%	15.5%

Nga të gjeturat e hulumtimit, qytetarët e *Fushë Kosovës* janë të gatshëm që të angazhohen vullnetarisht në zgjedhjen e disa nga problemeve mjedisore në komunitetin e tyre. Një përqindje e lartë prej 62.4% janë të gatshëm që të bëjnë punë vullnetare; 15.5% nuk e dine se a do të angazhoheshin kurse 22.1% nuk do të angazhoheshin në punë vullnetare. Në përgjithësi gadishmëria e meshkujve është më lartë për angazhim në punë vullnetare sa sa e femrave. Për ilustrim shih grafet e më poshtme.




3. VIZIONI ZHVILLIMOR

3.1. Çfarë mendoni se do të jetë gjendja e mjedisit në 5 vjetët e ardhshme në territorin e komunës suaj?

		më e mirë	e njëjtë	më e keqe	nuk e di
Gjinia	Mashkull	699	229	71	32
		67.8%	22.2%	6.9%	3.1%
Femer		708	176	62	34
		72.2%	18.0%	6.3%	3.5%
Total		1407	405	133	66
		70.0%	20.1%	6.6%	3.3%

Shumica e qytetarëve të intervistuar të *Fushë Kosovës*, janë optimist sa i përket gjendjes së ardhshme mjedisore. Në pyetjen, se çfarë mendoni se do të jetë gjendja mjedisore në pesë (5) vitet e ardhshme në territorin e komunës suaj? Shumica e respondentëve janë përgjigjur se do të jetë *më e mirë* me 70.0%, *e njëjtë* 20.1%, si dhe *më e keqe* me 6.6%. Pothujase mendimin e njëjtë ndajnë si femrat ashtu edhe meshkujt, për ilustrim shih tabelat e poshtë shënuara.





3.2. Rrumbullakësoni 3 problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj?

		1. zhurma	2. deponitë e mbeturinave komunale mbeturinat	3. ujërat e zeza	5. cilësia e ujit të pijshëm	7. rrugët e këqija lokale apo mungesa e parkingjeve,	10. mirëmbajtja e dobët e sipërfaqeve të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës
Gjinia	Mashkull	256	437	391	618	265	179
		12.8%	21.9%	19.6%	30.9%	13.3%	9.0%
Femer		284	476	377	637	255	181
		14.2%	23.8%	18.9%	31.9%	12.8%	9.1%
Total		540	913	768	1255	520	360
		27.0%	45.7%	38.4%	62.8%	26.0%	18.0%

Në pyetjen se cilat janë tri problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen tuaj, respondentët nga Fushë Kosova kanë përzgjedhur:

- i) **Cilësinë e ujit të pijshëm**, si problemin e parë
- ii) **Deponitë e mbeturinave komunale**, si problemin e dytë, dhe
- iii) **Ujrat e zeza**, si problemin e tretë.

Për më tepër shih ilustrimet grafike mbi problemet që më së shumti ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës në lagjen e tyre:



KONKLUZIONET

Shumica e të gjeturave nga hulumtimi e rikonfirmojnë përshtypjen tonë për problemet e ndryshme mjedisore që ekzistojnë nëpër komunat përkatëse. Megjithatë, çdo komunë dallohet për nga veçoritë e tyre mjedisore, si për shembull, Hani i Elezit, Obiliqi dhe Fushë Kosova problem primar e kanë ajrin e ndotur e për këto tri komunat është më se i ditur shkaktari i ndotjes së ajrit. Përderisa komunat tjera nuk e kanë këtë si problem primar.

Në pjesën për *perceptimin e gjendjes së tanishme mjedisore*, për të gjitha komunat përgjigjja e respondentëve është se gjendja e tanishme mjedisore nuk është e mirë dhe kjo lenë të nënkuptohet se duhet të punohet në përmirësimin e gjendjes mjedisore. Për këtë respondentët e shohin qeverinë lokale, ndërmarrjet publike komunale si dhe vetë qytetarët përgjegjës për të përmirësuar gjendjen mjedisore në territorin e komunës së tyre. Varësisht prej komunave, disa prej problemeve që kërkojnë adresim të menjëhershëm janë: *Menaxhimi i mbeturinave komunale, Ujërat e zeza/kanalizimet, Cilësia e ujit të pijshëm, Mos mirëmbajtja e zonave të gjelbra, parqeve dhe shiritave mbrojtës, Zhurma, Cilësia e ujit në lumenj dhe kanale, Mungesa informative dhe transparenca, Përdorimi i pakontrolluar i tokës bujqësore, Mungesa e shërbimeve komunale, Cilësia e ajrit, Ujërat e ndotura industriale*, si dhe problem tjera.

Në pjesën për *strategjinë e zhvillimit dhe informimit*, shumica e respondentëve të anketuar janë shprehur se nuk janë të informuar me qëllimet e strategjisë së zhvillimit komunal; komuna e tyre ka nevojë për një strategji të re zhvillimore dhe se zhvillimet e tanishme nuk përkujnë me nevojat e qytetarëve. Për këtë arsye administrata komunale duhet të zhvilloj një platformë të komunikimit me qytetarët e saj dhe të përfshijë ata në proceset e vendimmarrjes – në këtë rast në hartimin e PLVM-së. Nga hulumtimi është konfirmuar që qytetarët kryesisht informatat i marrin nga televizioni, radiot lokale, shtypi ditor dhe interneti. Këto medime do të duhej të ishin kanale përmes të cilave informohen qytetarët. Megjithatë, respondentët kanë përzgjedhur edhe kanale tjera të informimit të cilat janë specifike për komunat përkatëse.

Qytetarët e anketuar, shumë pak kanë njohuri rreth organizatave mjedisore që veprojnë në komunat përkatëse apo edhe për shërbimin komunal që merret me çështjet mjedisore. Për këtë organizatat mjedisore, si dhe shërbimi komunal për mjedis, duhen të jenë më prezentë me aktivitetet e tyre në komunitet si dhe më të zëshme në adresimin e problemeve mjedisore. Fakti më i vërtetuar me këtë hulumtim është se shumica e të anketuarve janë të gatshëm të bëjnë punë vullnetare për çështje mjedisore, me qëllim të përmirësimit të mjedisit në lagjet e tyre. Ky fakt do të duhej të përdoret nga organizatat jo-qeveritare mjedisore si dhe nga autoritet komunale për të pasur qytetarët aleat në veprimet mjedisore.

Në pjesën për *vizionin zhvillimor*, shumica e të anketuarve shpresojnë se në të ardhmen gjendja e mjedisit do të ndryshojë për të mirë. Kjo pritshmëri mund të arrihet me hartimin e PLVM-ve dhe jetësimin e tyre në praktikë, mirëpo çdo herë duke i informuar drejtë dhe duke i përfshirë qytetarët dhe grupet e interesit në proceset e vendimmarrjes.



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER



Republika e Kosovës
Ministria e MMPH dhe MAPI

